REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 414/22
Datë/Datum. 05.12.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 414/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi - Referuese, Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE "PUNTEX" & "SOLID" - Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me uniforma të punës për zjarrfikës" me nr. të prokurimit: 21432700-22-4837-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - AGJENCIA PËR MENAXHIMIN EMERGJENT (AME), me datën 05.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik OE "PUNTEX" & "SOLID" - Prizren, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 29.08.2022 me numër të protokollit 414/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me uniforma të punës për zjarrfikës" me nr. të prokurimit: 21432700-22-4837-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - AGJENCIA PËR MENAXHIMIN EMERGJENT (AME).

II. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, konform nenit 31 paragrafi 5 të Rregullores së Punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit;

A r s y e t i m

Me 11.08.2022, Autoriteti Kontraktues –AME ka publikuar Njoftimin për dhënie lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me uniforma të punës për zjarrfikës" me nr. të prokurimit: 21432700-22-4837-1-1-1.

Me datën 16.08.2022, OE "PUNTEX" & "SOLID" - Prizren" ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar nga AK.

Me 29. 08.2022 OE "PUNTEX" & "SOLID" - Prizren ka parashtruar ankesë me (Nr. protokolli: 414/22), kundër njoftimit për dhënie të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 15.09.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

- Ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Të anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Eksperti shqyrtues sqaron se: lidhur me pretendimin e OE ankues nr. 1 . dhe sqarimin e dhënë nga letra standarde e AK-së se OE ankues nuk e ka plotesuar kriterin e kërkuar sepse është kërkuar që llogo të jetë e AME-së, kurse mostra e OE ankues është me Llogo të Zjarrfiksave.

Eksperti shqyrtues mendon se edhe pse nuk është konform kërkesës por pasi që sqaron OE ankues se Llogoja është edhe në rroba, mendoj se ky mund të jetë një lëshim nga ana e OE i cili mund të riparohet, që nuk ndikon në procesin, pasi që Llogon e AME-se, e ka vendosur në veshje andaj mendoj se ky pretendim është pjeserisht i bazuar.

Përgjigje nr.2 & nr.3

Eksperti i **OSHP-se,** sqaron se lidhur me këtë pretendim ankimor unë si ekspert edhe pse siç pretendon OE ankues, OE nuk e ploteson kriterin e saktë siç e ka kerkuar AK-ja, por mendoj se kjo mund të qartësohet nga AK-ja, sepse mendoj që janë disa finesa të vogla si psh. Në pulla të shkruaj AME dhe një xhep i vogël e që nuk mendoj se janë të një rëndësie që një Operator - prodhues vendor të eliminohet për finesa të tilla, po ashtu lidhur me patentin YKK apo ekuivalent të gjitha këto paqartesi lidhur me kualitetin mund të vërtetohet kualiteti i tyre përmes Laboratorit të certifikuar.

Pra të gjitha këto mund të sqarohen sipas nenit 72 të LPP-së, rreth kualitetit përmes laboratorit dhe kjo bie mbi përgjegjësi të AK-së të verifikojë këto konform kualitetit. Pra, mendoj se AK duhet të

ketë parasysh kursimin e buxhetit sipas nenit 1 dhe 6 te LPP-së, që OE ankues i cili është mbi 157,000 € më i lirë se OE i rekomanduar. Eksperti shqyrtues mendon se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje nr.4

Eksperti i OSHP-së, sqaron se lidhur me pretendimin për artikullin e maicave që është kërkuar të jenë me tri qepje, kurse OE i rekomanduar e ka ofruar me dy qepje.

Edhe për këtë pretendim Eksperti i OSHP-se, sqaroj se lidhur me këtë pretendim se produkti nuk është siç është kërkuar 65 % poliester dhe 35% pambuk, dhe se OE ankues pretendon se produkti i ofruar është 65% poliester dhe 35% pelhurë.

Me këtë sqaroj se te ky pretendim lidhur me cilësinë kjo duhet të vërtetohet cilësia e produkteve nga një Laborator i licencuar lidhur me kualitetin e produkteve. Pretendimi ankimor i pjesërishëm.

Përgjigje nr.5

Eksperti i OSHP-së, sqaron se lidhur me pretendimin ankimor për kualitetin e pantollonave. Përgjegjësi e AK-së është të vërtetoj përmes ekspertëve të fushës perkatese, apo laboratoreve lidhur me qepjen dhe qëndrueshmërinë e tyre ashtu siç e ka kërkuar AK-ja.Pretendimi ankimor pjeserisht i bazuar.

Përgjigje nr.6

Eksperti i OSHP-së, sqaron se lidhur me pretendimin ankimor se për artikullin e maicave - fanellave profesionale me mangë të shkurtëra. Sipas fotove që po i shohim lidhur me qepjen dhe kualitetin, vetem organi kompetent mund të vendos dhe të jep fjalen profesionale.

Përgjigje nr.7

Eksperfi i OSHP-së sqaron se lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, lidhur me shtrojën e këpucave siç pretendon OE ankues se nuk e plotëson kriterin e kerkuar siç është e cekur. Poashtu, eksperti sqaron se edhe për këto duhet të vërtetohet kualiteti i tyre në një laborator të certifikuar, si për shtrojet, lëkuren, dhe për këpucen me qepje dhe te jep vleresimin Laboratori se a i përmbush kriteret e kërkuara kepuca apo jo.Pretendimi ankimor pjeserisht i bazuar.

Përgjigje nr.8

Eksperti i OSHP-se sqaron lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, se sipas FDT-së neni 9.1 & 9.2 i FDT-se është kërkuar certifikata ISO 9001:2015, kurse OE i rekomanduar e ka ofruar certifikaten ISO 9001:2008. Lidhur me këtë pretendim ankimor të OE ankues, se OE i rekomanduar e ka ofruar Certifikaten ISO 9001:2008, por është kerkuar ISO 9001:2015, me këtë eksperti i OSHP-së sqaroi se me rëndësi është afati i certifikatës që rëndësia e dy certifikatave është e njejtë.

Përgjigje nr.9

Eksperti i OSHP-së, sqaron se lidhur me kriterin e kërkuar të FDT-së, është përgjegjësi e AK-se të vlerësoj ofertat e OE-ve pjesëmarres konform kërkeses së FDT-së, pika h. Atestet raportet laboratorike të kryera të detajuara me vlera përkatëse për (Pantollona Veror dhe Dimror, Këpucë Dimrore dhe Verore si (dhe Xhaketa) të bëra nga një laborator me akreditim ndërkombëtar (ISO

EN 17025) përkatës për kontrollimin e cilësisë së materialit në emër të prodhuesit dhe produktit përkatës sipas kërkesës në dosje të tenderit Aneks 1 (atestet duhet te jenë në gjuhen shqipe apo angleze), sipas nenit 59 te LPP-së, dhe në rast se ka ndonjë paqartësi lidhur me verifikimet e certifikatës në fjalë, AK mund të kërkoj ekspert nga Dogana e Kosovës, konkretisht nga njësia e Laboratorit, për arsye se janë persona kompetent për verifikimin e tyre. Pretendimi ankimor pjeserisht i bazuar

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç'rast OE ankues pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërsa AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli Shqyrtues mori në shqyrtim të gjitha shkresat në dispozicion të kësaj lënde, çdo parashtresë të palëve, AK dhe OE dhe ekspertizën e ekspertit shqyrtues duke e analizuar secilin nga pretendimet e ngritura me ankesë. Në kontekstin e kësaj lënde, natyrës dhe specifikave të sajë, Paneli veçoi secilin nga pretendim ankimor dhe secilën përgjigje apo konstatim të AK dhe ekspertit shqyrtues

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës, Paneli konstatoi se pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, i referohen në fakt vendimit mbi Dhënien e Kontratës, sipas të cilit autoriteti kontraktues ka dhënë përfundimisht një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura dhe duke i ndërmarrë një serë veprimesh të cilat parashihen shprehimisht me LPP, pa nevojë që të njëjtat të përshkruhen në ketë rast. Sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës, apriori pretendimet ankimore nuk konsistojnë në faktin nëse është atakuar apo jo interesi ekonomik i Ankuesit, por ato atakojnë shkaqet dhe arsyet mbi bazën e të cilave AK, ka rekomanduar për kontratë një tjetër OE. Po ashtu, Ankuesi fare nuk i ka mbrojtur arsyet mbi bazën e eliminimit të tij nga AK, duke e pranuar faktin dhe duke i quajtur ato si elemente minore. Prandaj parashtruesi i ankesës nuk mund ta ketë tani në ketë fazë statusin e palës me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Prandaj, si rrjedhojë e fakteve dhe rrethanave të përshkruara shkurtimisht si më sipër, Paneli konsideron se tani në ketë fazë të përmbylljes së aktivitetit të prokurimit, pretendimet ankimore janë jo relevante, përderisa i njëjti nuk ka arritur ta dëshmoj statusin e një OE të përgjegjshëm sikurse kërkohet me nenin 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës) të LPP. Përveç kësaj AK duhet ti ketë parasysh edhe dispozitat e neneve 1 dhe 7, përmbajtja e të cilave përbën fakt notor për të gjitha AK dhe OE.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, "*Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar") në nenin 4 te këtij ligji*". Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar ne ketë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritor të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 të LPP, të cituara në Ankesë, meqë e ka hartuar dosjen e tenderit në pajtim me kërkesat e domosdoshme, të parashikuara shprehimisht me dispozitën e nenit 27 (Dosja e Tenderit) lidhur me nenin 28 (Specifikimet teknike) të Ligjit të cituar kurse kriteret e aplikuar dhe veprimet e ndërmarra nuk karakterizohen me natyrë diskriminuese. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshtesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Vedat POTERQOI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK – AME;
1x1 OE- "PUNTEX" & "SOLID" - Prizren";
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.